


BULETIN

Sekretariati i




Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime

BERZH - STRATEGJIA E RE 5-VJEÇARE E VENDIT PËR KOSOVËN




Speaking: Lindita Dajja



KONFERENCA VJETORE E SEKRETARIATEVE TË KËSHILLAVE TË INVESTIMEVE - BERZH

TAKIMI ME ZËVENDËS KRYEMINISTRIN BISLIMI






BERZH - STRATEGJIA E RE 5-VJEÇARE E VENDIT PËR KOSOVËN

BERZH është duke përgatitur Strategjinë Zhvillimore për Kosovën, 2022-2026. Pas konsultimeve me Kryeministrin, MFPT, ME dhe MINT, BERZH ka vazhduar konsultimet me përfaqësuesit e sektorit privat dhe Sekretariatit të KKEI rreth Strategjisë së re 5 vjeçare të BERZH për Kosovën. Në këtë takim nga BERZH morrën pjesë Neil Taylor, Udhëheqës i zyrës së BERZH për Kosovë; Leonora Kusari, Koordinatore Regjionale për BVM; Ana Kresic, Ekonomiste për Evropën Lindore dhe Kaukazin, BERZH; Peter Sanfey, Drejtor i Asociuar për Ekonomi, Politikë dhe Qeverisje; Caroline Galvan, Drejtore e Asociuar, Këshilltare e Lartë; Allouzi Anoud, Analiste, Koordinatore e Strategjisë së Vendit. Neil Taylor, prezantoi prioritetet strategjike ku ndër to parashihet edhe zhvillimi i ekonomisë përmes forcimit të konkurrencës, mbështetja e tranzicionit drejt ekonomisë së gjelbërt, forcimi i integritit regional dhe investimeve të huaja. Përfaqësuesit e sektorit privat prezantuan rekomandimet dhe idetë e tyre në lidhje me strategjinë kombëtare dhe parashtruan pyetje rreth mënyrës së bashkëpunimit në zbatimin e këtyre prioriteteve.

Për fund, bazuar në analizat e Sekretariatit të KKEI rreth sektorit privat, udhëheqësja e këtij Sekretariati, Lindita Daija, potencoi se shtyllat kryesore në të cilat Kosova ka nevojë të fokusohet me qëllim të përmirësimit të zhvillimit ekonomik janë ulja e informalitetit, mbështetja e bizneseve prodhuese si dhe bizneseve që ofrojnë shërbime; drejt mundësive të eksportimit të mallërave dhe shërbimeve, si dhe nevoja për rritjen e kualitetit dhe standardeve për konkurrueshmëri, identifikimi i shtyllave kryesore të industrisë si dhe identifikimi i nevojave aktuale të tregut të punës.

Konferenca vjetore e Sekretariateve të Këshillave të Investimeve - BERZH



Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) ka mbajtur konferencën vjetore të Sekretariateve të Këshillave të Investimeve të udhëhequr nga shtylla e Qeverisjes së mirë dhe Çështjeve Politike. Të pranishëm në këtë konferencë ishin Ministra të fushës së Ekonomisë dhe udhëheqës të sekretariateve të këtyre këshillave nga vende të ndryshme të botës, si dhe përfaqësues të zyrës qendrore të BERZH në Londër. Sekretariati i Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime u përfaqësua nga udhëheqësja e tij, znj. Lindita Daija. Temat kyçe të kësaj konference ishin zhvillimi i ekonomisë së qëndrueshme, mundësitë e barabarta si dhe digjitalizimi.

Znj. Daija gjatë fjalimit të saj prezantoi punën e Këshillit gjatë viteve të fundit, e posaçërisht gjatë periudhës së pandemisë, ku Këshilli ka luajtur rol crucial në menaxhimin e situatës si dhe në përpilimin e pakos së rimëkëmbjes. Poashtu, ajo theksoi punën e mirë që është bërë në bashkëpunim me odat ekonomike dhe sektorin publik në identifikimin dhe trajtimin e sfidave lidhur me ambientin e të bërit biznes, ekonominë e gjelbërt, dhe digjitalizimin.



Udhëheqësja e Sekretariatit të KKEI-së takohet me Zëvendës Kryeministrin Bislimi

Udhëheqësja e Sekretariatit të KKEI-së, znj. Daija, u takua me Zëvendës Kryeministrin e Kosovës, zt. Besnik Bislimi së bashku me përfaqësues të Berzh-it, si mbështetës të Sekretariatit të KKEI, për të diskutuar lidhur me vazhdimësinë e punës së Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime në Kosovë, pritshmërive të sektorit privat, mbi rolin e Këshillit, si dhe mbi prioritetet në fushën e zhvillimit ekonomik.

Si platforma e vetme zyrtare e konsultimit të Qeverisë me përfaqësuesit e bizneseve, është e rëndësishme të planifikohen aktivitetet me tematikat e nevojshme për t'u diskutuar në Këshillin Kombëtar për Ekonomi dhe Investime.

SEKRETARIATI I



Mbështetur nga



European Bank
for Reconstruction and Development

Shtator, 2021



Ministria e Ekonomisë, Sheshi "Zahir Pajaziti", (ish ndërtesa e Toskanës) 10000 Prishtinë

www.ncei-ks.com



+383 38 200 215 53



info@nced-ks.com

